



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 703/ Prot

Tiranë, më 24.02.2026

V E N D I M

Nr. 13, datë 24.02.2026

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË REDUKTIM TË
TARIFËS SË SHKOLLIMIT ME 50% NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026 (faza e parë)”**

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 703 Prot., datë 19.02.2026, në mbledhjen e tij të datës 24.02.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve, që përfitojnë reduktim të tarifës së shkollimit me 50% në programet e ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2025-2026 (faza e parë) (sipas tabelës bashkëlidhur).

2. Efektet financiare të këtij vendimi për 48 (dyzetë e tetë) studentë që plotësojnë kriterin, janë në vlerën **1,611,000** (një milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetëmijë) lekë.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI

Kryetar

Matilda SHABANI

Anëtar

Albert KOPALI

Anëtar

Edmond KADIU

Anëtar

Blerina DUKA

Anëtar

Altin PRENGA

Anëtar

Ilir KUSI

Anëtar

